

## E HENA E PASHKES

*Kjo Shërbesë bëhet të Hënën e Pashkës së Madhe në mëngjes.*

DHJAKU: Beko, o Atë.

PRIFTI: I bekuar është Perëndia ynë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

*Pastaj këndohet tri herë Përlëshorja e Pashkës, një herë prej Priftit edhe nga një herë prej të dy Valleve:*

## PERLESHORJA E PASHKES

### KHRISTOS ANESTI

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet' u dhuroj të re. **(3 herë)**

*Pastaj këndohen pa zë Troparet pasonjëse:*

Passi pamë Ngjalljen e Krishtit, le ta adhurojmë Zotin e Shenjtë Jesu, të vetëmin të pamëkatmë. E adhurojmë Kryqin tënt o Krisht, edhe e hymnojmë dhe e lavdërojmë Ngjalljen tënde të Shenjtë, se ti je Perëndia ynë, veç teje nukë njohim tjetër, dhe emërojmë emrin

tënt. Ejani të gjithë, o besnikë, ta adhurojmë Ngjalljen e Shenjtë të Krishtit; se ja ku ardhi gëzimi në tërë botën me anën e Kryqit. Pra e bekojmë kurdoherë Zotin, edhe e hymnojmë Ngjalljen e tij, se duroj Kryqin për ne dhe e shkeli vdekjen me vdekje. **(3 herë)**

Kur arthnë Gratë me Marinë përpara agimit, edhe e gjetnë gurin të rrugullizur, Engjëlli u tha: Si e kërkoni si njeri me të vdekurit, atë që rron në dritën e ameshuar? Rentni dhe lëçitini botës, që Zoti u-ngrit, edhe e vrau vdekjen, se është i Biri i Perëndisë, që shpëtoj gjindjen e njerësve.

O i pavdekur që zbritë në varr për ne, dhe e dërmovë Skëterrën o Zot përdhe, dhe u-ngjalle si fitimtar o Krisht Perëndi, edhe Grave me myrra u thirre Gezohuni, dhe u dhurove paqen e qjellit dishepujve, ti që u fale Ngjalljen të rënëve.

Në varr me trup si njeri, në Ferr me shpirt e dritë si Perëndi, dhe në Parajsë tok me një Kusar, edhe ndënje mi fronin o Krisht, me Atin dhe me Shpirtin Shenjt, botën e mbush, i papërshkruari.

LAVDI. Si jetëprurës na u-tregua, varri yt më i bukur, më i ndriçim se çdo pallat mbretëror, se andej na lindi na buroj, o Krisht o Perëndi, ngjallja edhe shpëtim' i shpirtëve.

TANI. Gëzohu o banes' e të Lartit, Virgjëreshë gezohu, se na linde Zotin Krisht Perëndi, Shpëtimtarin e besnikëve; pra e bekuar je në mes të grave, o Zonjë Hyjlindëse.

KENDONJESI: Mëshiro, o Zot. **(40 herë)**

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

Ti je e nderuar mi Kerubim, dhe e lavdëruar pa përjasje mi Serafim, ti me të vertetë linde Fjalë Perëndinë, pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyj lindëse.

Mëshiro o Zot. (3 herë)

Beko, o Atë, më emrin e Zotit.

PRIFTI: I bekuar je, o Krisht o Perëndia ynë, gjithënjë, tani dhe përherë, dhe në jetët e jetëve.

KORI. Amin.

*Pastaj thuhet Përlëshorja e Pashkës pa zë:*

U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe të varrosurve, një jet u' dhuroj të re. (3 herë).

*Këndimet e sipërme thuhën tërë javën e Pashkës në vëndin e Pasdarkave, Mesnatorëve, dhe Orëve. Në mëngjes, pas këtyre këndimeve, Prifti thotë me zë të lartë:*

PRIFTI: Lavdi Trinisë së Shenjtë, së bashkëqënshime, jetëbërëse, dhe së pandarë, gjithënjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

*Pastaj këndohet Tropari i Pashkës me Vargjet, Litania e Madhe, Kanuni i Pashkës, Madhështimet, edhe Dërgimësorja si në Ngjalljen e Parë.*

## LAVDERIMET, T. II.

*Këndohen katër të Tingëllit edhe katër të Pashkës:*

Çdo frymë dhe çdo krijesë, ty të lavdëron o Zot, se me kryqësimin tënt e shove vdekjen krejt, dhe u çpalle

popujve, Ngjalljen e gjithë njerësve, o Zot i mëshirave.

Tregoni o të pabesë, si e qysh ata që e ruanin, e humpnë natën Jesunë, dhe përse vallë guri nuk e ruajti dot gurin jetësor? A të varrosurin kthenani, a si të ngjallur adhurojeni; thoni pra tok me ne: O Shpetimtar i zëmërdhëmpshur, o Zot lavdi më ty.

Gëzohuni dhe ngazëllohuni o popuj, Engjëlli i qiellit që po rrinte mi varrin tënt, ay na lajmëroj edhe na tha: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, Shpëtimtar i botës, dhe e mbushi gjithësinë me erë lulesh, gëzohuni o popuj dhe ngazëllohuni.

Gratë me myrra dhe me lote, mi varrin t' arthnë o Jetëdhënës, dhe me gas e përhapnë lajmën kudo, që Zoti u-ngjall prej së vdekurësh.

*Pastaj këndohen Lavdërimet e Pashkës, Lavdia e Pashkës, dhe nis menjëherë Meshja e Shën Joan Gojartit:*

DHJAKU: Beko, o Atë.

PRIFTI: E bekuar është Mbretëria e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

*Pastaj tri herë Tropari i Pashkës dhe Litania e Madhe. Në Hyrjen këndohen Troparet e Pashkës, dhe në vënt të Hymnit Trishenjtor thuhet:*

Sa u-pagëzuat më Zotin Krisht, u-veshtë me Zotin Krisht, Alilluia.

## APOSTULLI

Fjala e tyre u-përhap në tërë dhenë.

Qielli tregon lavdinë e Perëndisë.

Këndimi prej Akteve të Apostujve.

Më ato ditë, dishepujtë u-kthyen në Jerusalem nga mali i quajtur i Ullishtes, i cili është një ditë udhe pranë Jerusalemit. Edhe kur hynë në qytetin, u-ngjitrën në një dhomë të sipërme, ku prisnin Pjetri, dhe Jakobi, dhe Andreu, Filipi, dhe Thomaj, Barthollomeu, dhe Matheu, Jakobi i biri i Alfeut, edhe Simon Zelloti, dhe Juda i vëllaj i Jakobit. Këta të gjithë vazhdonin me një mendje faljet edhe lutjet, bashkë me gratë dhe me Marinë, t'ëmën e Jesujt, edhe me të vëllezërit. Edhe më ato ditë, Pjetri qëndroj në mes të dishepujve, të cilët ishin nja një qint e njëzet nga numri i emrave, dhe u tha: "Burra vëllezër, duhej të plotësohej ajo Shkripturë, të cilën Shpirti i Shenjtë na e parëtha me gojën e Davidit përmi Judën, i cili u-bë udhëheqësi i atyre, që e zunë Jesunë. Se ishte i nëmëruar me ne, edhe mori pjesë në shërbimin tonë. Përandaj, nga ata njerës, të cilët kanë qënë shokë tanë tërë kohën, qëkur na ardhni gjer sa na shkoj Zoti Jesu, dyke nisur nga pagëzimi i Joanit gjer ditën që fluturoj nga mezi ynë, duhet të zgjedhim një njeri, i cili të jetë dëshmor i Ngjalljes së tij tok me ne. Edhe caktuan dy veta, Josefin, i cili quhej Barsaba me llagapin e Justit, edhe Matthinë. Edhe u-falën, dhe thanë: "Ti, o Zot, që ua njuh të gjithëve zemrat, tregona cilin ke zgjedhur nga këta të dy që të marrë pjesë në këtë shërbim dhe apostullatë, dhe të zerë vëndin e Judës. i cili u-rrëzua prej këtyre me tradhësinë e tij. Edhe i dhanë votat, edhe vota i ra Matthisë, i cili hyri në radhën e të njëmbëdhjetë Apostujve.

#### UNJILLI PAS JOANIT

Zoti tha: Askusk nuk e ka parë Perëndinë nonjë

herë. Biri i vetëm, i cili është në gjirin e Atit, ay e ka lëçitur. Edhe ky është dëshmimi i Joanit, kur Judenjtë i dërguan Priftërinj edhe Levitë nga Jerusalemi, dhe e pyetnë: "Cili je?" Edhe ay e tregoj, dhe nuk e mohoj, po tha: "Unë nukë jam Krishti." Edhe ata e pyetnë: "Ahere a je Elia?" Edhe ay u-përgjeh: "Nukë jam." Edhe ata e pyetnë: "A je ay Profet?" Edhe ay u-përgjeh: "Jo." Edhe ata e pyetnë: "Cili je? Na thuaj që tu japim përgjigjen atyre, që na kanë dërguar. Ç' thua për veten tënde?" Edhe ay u-përgjeh: "Unë jam zëri i ati, që thërret në shketëtirën: Gatiteni udhën e Zotit, sikundër tha Profeti Isaia." Edhe ata, që u-dërguan, ishin Farisianë. Edhe e pyetnë përsëri, dhe i thanë: "Ahere përse pagëzon posa nukë je as Krishti, as Elia, as ay Profet?" Edhe Joani u-përgjeh, edhe u tha: "Unë pagëzonj me ujë, po në mes tuaj qëndron dikush, të cilin ju nuk e njihni. Ay është që vjen pas meje, po qëndron përmi mua, ati unë nukë jam i vyer tja zgjith rripin e këpucës." Këto gjera u-bënë në Bethabarë përtej Jordanit, ku pagëzonte Joani.

Të nesërmen Joani e pa Jesunë, që i vinte, edhe tha: "Ja qengji i Perëndisë, që e ngre mëkatën e botës. Ky është ay, për të cilin kam thënë: 'Pas meje vjen dikush, i cili qëndron përmi mua, se ay ishte përpara meje.' Edhe unë nuk e njihnja, po përandaj kam ardhur, edhe pagëzonj me ujë, që ta çfaq përpara Israelit." Edhe Joani dëshmonte dhe thoshte: "E pashë Shpirtin, që zbriti nga qjelli si një pullump, edhe qëndroj mi atë. Edhe unë nuk e njihnja. Po ay, që më ka dërguar të pagëzonj me ujë, ay më tha: 'Ay, mi të cilin do të shikosh që të zbresë dhe të qëndronjë Shpirti, ay është që pagëzon me Shpirtin e Shenjtë.' Edhe unë e pashë, edhe dëshmonj që ky është i Biri i Perëndisë."

*Pastaj Mesha vazhdon si ditën e Pashkës. Pas Uratës Përpara Tribunës këndohet tri herë pa zë Përlëshorja e Pashkës, dhe bëhet Përlëshimi i Pashkës. Shërbesa e sipërme përsëritet edhe ditët e tjera të Javës së Pashkës me ndryshimin e Apostullit, Ungjillit, edhe Tingëllit të ditës. Tingëjthe këndohen me radhë tërë javën, dyke nisur me Tingëllin I ditën e Pashkës së Madhe, me Tingëllin II të Hënën e Pashkës, dhe kështu tutje gjer të Premten e Pashkës, kur këndohet Tingëlli Tërthor II. Të Shtunën e Pashkës këndohet Tingëlli Tërthor IV, edhe të Dielën e Shën Thomajt nis përsëri T. I., po këtë herë çdo Tingëll vazhdon tërë javën.*